

DEKRET
Nr.7442, datë 17.12.1990

PËR KRIJIMIN E ORGANIZATAVE E SHOQATAVE POLITIKE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, në bazë të nenit 54, të Kushtetutës, shtetasve u njihet e drejta të formojnë organizata (parti) ose shoqata politike e shoqërore.

Neni 2

Veprimtaria e partive ose e shoqatave politike mund të shtrihet për një a disa rrethe ose në gjithë territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 3

Shtetasit që dëshirojnë të formojnë parti ose shoqatë politike, detyrohen t'i drejtojnë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë duke paraqitur programin dhe rregulloren ose statusin ose statutin e partisë apo të shoqatës së tyre.

Neni 4

Kërkesa për formimin e një partie opse shoqate politike duhet të nënshkruhet të paktën nga 100 shtetas, kur veprimtaria e kësaj partie qe shoqate do të shtrihet në një ose në disa rrethe, dhe mbi 300 shtetas, kur veprimtaria e tyre do të shtrihet në gjithë territorin e vendit.

Neni 5

Ministria e Drejtësisë, ikur vëren se nuk janë zbatuar rregullat e caktuara në këtë dekret, e kthen kërkesën për plotësimet përkatëse.

Neni 6

Ministria e Drejtësisë duhet të miratojë ose të refuzojë formimin e partisë a të shoqatës politike brenda 30 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të kërkesës.

Në rast se brenda këtij afati nuk përfundon shqyrtimi i kërkesës, ajo konsiderohet si e pranuar.

Neni 7

Orani kompetent nuk miraton formimin e partive ose të shoqatave politike dhe ndalon vazhdimin e veprimtarisë së tyre, kur ato kanë karakter fashist, racist, luftënxitës, antikombëtar ose nxitin urrejtjen kombëtare, si dhe kur synojnë përmbysjen me dhunë të rendit të vendosur në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ndalohet formimi dhe veprimtaria e një partie a shoqate politike, kur themeluesit ose ata që bëjnë pjesë në udhëheqjen e saj frymëzohen nga idetë e përmendura në këtë dispozitë.

Neni 8

Nuk mund të marrin pjesë në formimin e një partie ose shoqate politike dhe as të jenë anëtarë të tyre, shtetasit e huaj dhe shtetasit shqiptarë që nuk kanë vendbanim të përhershëm në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 9

Kundër aktit të Ministrisë së Drejtësisë që refuzon kërkesën për formimin e një partie a shoqate politike ose që ndalon vazhdimin e veprimtarisë së tyre, mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit, në Gjykatën e Lartë, e cila brenda 15 ditëve merr vendim të formës së prerë.

Neni 10

Rregullorja a statuti i partive ose shoqatave politike, ndër të tjera, duhet të përmbajë emrin e partisë a të shoqatës, organizimin e brendshëm, qëllimin e krijimit, qendrën e tyre dhe territorin në të cilin do të zhvillojnë veprimtarinë, si dhe burimin e mjeteve materiale që do të përdorin.

Neni 11

Partitë ose shoqatat politike janë persona juridikë. Ato dp të kenë pasuri të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë dhe shtypin e tyre, si dhe do të administrojnë të ardhurat që vijnë nga pagimi i kuotave të anëtarësisë dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Partive ose shoqatave politike u ndalohet të marrin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi ndihma financiare nga jashtë, si shtete, parti, organizata, institucione, individë të huaj ose nga shqiptarë që nuk janë me banim të përhershëm në Shqipëri. Në rast të kundërt shteti bën konfiskimin e këtyre ndihmave.

Neni 12

Partitë dhe shoqatat politike detyrohen të shpallin një herë në vit burimin, sasinë dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të tyre.

Neni 13

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI SIHAT TOZAJ	KRYETARI RAMIZ ALIA
--------------------------	------------------------